



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Nr. 9270 prot.

Kamëz, më 08.09.2026

U R D H Ë R

Nr. 720, Datë 08.09 2026

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË
SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NË BASHKINË
KAMËZ”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 96/2025, datë 18.12.2025 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”; ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”;

U R D H Ë R O J

1. Miratimin e rregullores “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

K R Y E T A R I

Rakip SULLI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Nr. 9270 prot.

Kamëz, më 08.09.2026

**RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË BASHKINË KAMËZ**

Kamëz/ SHITATOR/2026

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

NENI 1 BAZA LIGJORE

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashki, bazohet në Ligjin nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI.

NENI 2 OBJEKTI

Objekti i Rregullores është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe i mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të Ligjit nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.

NENI 3 PËRKUFIZIME

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Institucioni”, autoritet publik Bashkia Kamez
2. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
3. “Njësi përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda Bashkisë Kamëz i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit dhe ndjekjen e saj sipas përcaktimeve të ligjit nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.
4. “Sinjalizim” është raportimi apo sinjalizimi i informacionit verbal ose me shkrim nga sinjalizuesi tek njësi përgjegjëse, për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera në një mjedis pune në autoritetin publik, nëpërmjet kanaleve të brendshme, të jashtme ose nëpërmjet publikimit, në përputhje me ligjin nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.
5. “Ndjekje” nënkupton çdo veprim të marrë nga njësi përgjegjëse për të vlerësuar saktësinë e pretendimeve të parashtruara nga sinjalizuesi dhe për të trajtuar shkeljen e sinjalizuar.
6. “Sinjalizim anonim” është sinjalizimi i kryer nga një sinjalizues, identiteti i të cilit nuk është i njohur për njësinë përgjegjëse në momentin e paraqitjes së sinjalizimit, ose kur vetë sinjalizuesi ka kërkuar të mbetet anonim gjatë këtij procesi.
7. “Sinjalizim i brendshëm” është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse të institucionit, sipas ligjit nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.
8. “Sinjalizim publik” është sinjalizimi, zbulimi ose komunikimi publik i informacionit në lidhje

me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.96, datë 18.12.2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nëpërmjet medias *online* dhe sociale, takimet publike, njoftimet publike e të gjitha komunikimet verbale, të shkruara dhe të regjistruara.

9. “Sinjalizues” është çdo person fizik që në një kontekst pune sinjalizon ose publikon informacione për shkelje të mundshme.

10. “Kontekst pune” është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme, përmes së cilës një person, pavarësisht nga natyra e saj juridike, ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, përfshirë marrëdhëniet e punësimit ose të vetëpunësimit, ofrimin e shërbimeve, kontratat e furnizimit, nënkontraktimin, si dhe aktivitetet vullnetare apo praktikat profesionale.

11. “Veprim hakmarrës” është çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i ndërmarrë në një kontekst pune, që ndodh pasi një individ ka sinjalizuar ose planifikon të sinjalizojë një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor nëpërmjet mekanizmave të brendshëm, të jashtëm ose publikisht, që shkakton ose mund të shkaktojë dëm për sinjalizuesin.

KREU II

VEPRIMTARIA e NJËSISË PËRGJEGJËSE

NENI 4

PARIMET E VEPRIMTARISË

Njësia Përgjegjëse në zbatim të Ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, bazohet në parimet dhe ushtron kompetencat:

- a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizuesit;
- b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
- c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
- d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit;
- g. duke zbatuar mekanizma të efektshëm dhe të përshtatshëm, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- h. duke përfunduar procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

NENI 5

DETYRAT E NJËSISË PËRGJEGJËSE

1. Njësia përgjegjëse ka detyrimin:

Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 492 Kamëz, tel.: +355 47 200 177, e-mail: info@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al

- a) të pranojë, të regjistrojë dhe të konfirmojë marrjen e sinjalizimit, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos merret konfirmim ose kur konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij;
 - b) të ndjekë me përgjegjshmëri e të informojë sinjalizuesin për ecurinë e sinjalizimit dhe rezultatin përfundimtar, jo më vonë se 3 muaj nga data e konfirmimit të regjistrimit të sinjalizimit. Ky afat zbatohet edhe në rastet kur konfirmimi nuk është dërguar;
 - c) të sigurojë që kanalet e sinjalizimit të organizohen e të funksionojnë në mënyrë të sigurt, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të çdo personi të tretë të përmendur në sinjalizim, si dhe duke parandaluar aksesin e paautorizuar ndaj informacionit të përfshirë në sinjalizim;
 - ç) të sigurojë informacion të qartë e të nevojshëm për procedurat e raportimit të brendshëm, përfshirë mënyrën e përdorimit të tyre dhe masat e mbrojtjes për sinjalizuesit;
 - d) njësia përgjegjëse informon automatikisht sinjalizuesin jo vetëm për veprimet e ndërmarra ose të parashikuara si ndjekje të mëtejshme, por edhe për arsyetimin përkatës në çdo rast dhe pa qenë nevoja për kërkesë specifike nga sinjalizuesi.
2. Punonjësi i ngarkuar me trajtimin e sinjalizimeve në njësinë përgjegjëse gëzon pavarësi në ushtrimin e kompetencave të tij, veçanërisht në rastet kur sinjalizimi lidhet me veprimtarinë e punëdhënësit ose përfshin masa për mbrojtjen e sinjalizuesit.
 3. Punonjësi i autorizuar për regjistrimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve gëzon të drejtën e mbrojtjes sipas ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nëse bëhet objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të ushtrimit të detyrës.
 4. Nëse sinjalizimi është marrë nga një person që nuk është i autorizuar për të vepruar sipas ligjit, ky person ka detyrimin ta përcjellë pa vonesë sinjalizimin te punonjësi i njësisë përgjegjëse ose tek autoriteti kompetent (ILDKPKI), duke ruajtur identitetin e sinjalizuesit dhe të çdo informacioni, që mund ta zbulojë atë.

KREU III

PROCEDURAT E VEPRIMIT

NENI 6

KRYERJA E VEPRIMEVE PROCEDURIALE

1. Veprimet procedurale të njësisë përgjegjëse kryhen në përputhje me ligjin nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat njësia përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

NENI 7

FORMA DHE PËRMBAJTJA E SINJALIZIMIT

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të caktuar të njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Nëse sinjalizimi verbal kryhet nëpërmjet një linje telefonike ose një sistemi tjetër të mesazheve

Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 492 Kamëz, tel.: +355 47 200 177, e-mail: info@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al

zanore, sinjalizuesi informohet paraprakisht nëse biseda do të regjistrohet.

3. Punonjësi i caktuar i njësisë përgjegjëse dokumenton sinjalizimin verbal në një procesverbal, ose kryen një transkriptim të sinjalizimit, kur ky i fundit kryhet në linjë telefonike ose me një sistem tjetër të mesazheve zanore. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e procesverbalit apo transkriptimit, duke e nënshkruar atë. Në pamundësi për ta nënshkruar transkriptimin, sinjalizuesi mund të konfirmojë përmbajtjen edhe me anë të një komunikimi drejtuar njësisë përgjegjëse.
4. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënat e identitetit dhe kontaktit të sinjalizuesit, me përjashtim të rasteve kur sinjalizimi është kryer në mënyrë anonime;
 - b. organin ose personin e përfshirë ndaj të cilit raportohet shkelja;
 - c. përshkrimin e informacionit për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të shoqëruar me fakte, rrethana dhe dokumentacion mbështetës, për aq sa është e mundur;
 - ç. Referimin përkatës të legjislacionit të shkelur, për aq sa është e mundur;
5. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.
6. Sinjalizimi plotësohet sipas formatit “Formular i sinjalizimit të brëndshëm”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

NENI 8

SINJALIZIMI ANONIM

1. Sinjalizimet anonime trajtohen nga njësia përgjegjëse në të njëjtën mënyrë, si çdo sinjalizim tjetër, pa vendosur kushte shtesë për marrjen, shqyrtimin dhe verifikimin e tyre.
2. Në rast se sinjalizuesi nuk jep pëlqimin e tij të shprehur për identifikim, sinjalizimi trajtohet si sinjalizim anonim.
3. Identiteti i sinjalizuesit, në rastet kur identifikohet, mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.

NENI 9

SINJALIZIMI I DREJTPËRDREJTË PRANË ILDKPKI

Sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja, në rastet kur:

- a. sinjalizimi është kryer fillimisht pranë njësisë përgjegjëse në bashki dhe sinjalizuesi vlerëson se shkelja nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda autoritetit publik;
- b. ekziston rrezik për veprime hakmarrëse ndaj sinjalizuesit, ose personave të lidhur me të;
- c. sinjalizuesi ka paraqitur fillimisht sinjalizimin pranë njësisë përgjegjëse dhe nuk është informuar për ecurinë ose trajtimin e sinjalizimit;

- ç. njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ të sinjalizimit ose njësia përgjegjëse e përfundon hetimin në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- d. ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuror ose personal, në veprimin e kundërligjshëm. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- dh. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;
- e. prova/t e sinjalizuesit, në lidhje me veprimet e kundërligjshme apo shkeljen e mundshme të kuadrit ligjor, mund të fshihen ose të shkatërrohen nga institucioni.

NENI 10

MOSFILLIMI I HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Njësia përgjegjëse vendos të mos fillojë hetimin administrativ nëse;
 - a. sinjalizimi, me përjashtim të rasteve të sinjalizimit anonim, nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga ligji nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për plotësim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
 - c. nga përmbajtja e sinjalizimit si dhe nga verifikimi paraprak rezulton qartë se nuk ekzistojnë elemente të kundërvajtjes administrative ose të një vepre penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të njësisë përgjegjëse.
3. Në dosjen e sinjalizimit dokumentohet vendimi për mosfillimin e hetimit administrativ, arsyet përkatëse që justifikojnë vendimmarrjen dhe çdo masë e marrë në lidhje me sinjalizimin.
4. Ky vendim i përcillet sinjalizuesit në çdo rast, së bashku me arsyetimin përkatës, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e tij.

KREU IV

HETIMI ADMINISTRATIV

NENI 11

REGJISTRIMI I SINJALIZIMIT

1. Sinjalizimi regjistrohet në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik, për regjistrimin e sinjalizimeve, sipas formularit “Regjistrimi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse në bashki” bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Njësia përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

NENI 12

VERIFIKIMI PARAPRAK

Njësia përgjegjëse kryen verifikim paraprak të sinjalizimit të regjistruar për të verifikuar nëse nga përmbajtja e tij ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se informacioni i sinjalizuar përmban elemente të një kundërvajtjeje administrative ose të një vepre penale.

NENI 13

TRAJTIMI ME PËRPARËSI I SINJALIZIMIT

1. Njësia përgjegjëse trajton sinjalizimet duke marrë për bazë radhën sipas parimit të kohës së regjistrimit të sinjalizimit.
2. Në rastet kur ka për trajtim një numër të lartë sinjalizimesh, me vendim të njësisë përgjegjëse, i jepet përparësi sinjalizimeve që lidhen me çështje me interes të lartë publik, që përfshijnë, por pa u kufizuar, rastet:
 - a. që kanë të bëjnë me rreziqe aktuale apo që ndikojnë në shëndetin publik, sigurinë ose të drejtat dhe liritë themelore;
 - b. që përfshijnë funksionarë të lartë në funksione publike;
 - c. që lidhen me interesa financiare të bashkisë ose të BE-së;

NENI 14

KËSHILLIMI PËRPARA RAPORTIMIT TË SINJALIZIMIT

1. Në rast se sinjalizuesi kërkon këshillim përpara regjistrimit të sinjalizimit sipas kësaj rregulloreje, punonjësit e caktuar për këshillim nga Kryetari i Bashkisë japin informacion të përgjithshëm mbi të drejtat që gëzon sinjalizuesi sipas nenit 6 të Ligjit nr.96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe procesin në tërësi. Punonjësit që angazhohen në dhënien e këshillimit, nuk mund të ushtrojnë detyrën e punonjësit të autorizuar për trajtimin e sinjalizimit.
2. Veprimtaria këshilluese nuk konsiderohet raportim i sinjalizimit në kuptim të Ligjit nr.96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe të kësaj rregulloreje dhe nuk regjistrohet në regjistrin e sinjalizimit.

NENI 15

PROCEDURA E HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Njësia përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia përgjegjëse zbaton dispozitat e Kodit të

Procedurave Administrative.

2. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e fillimit të saj.
3. Njësia përgjegjëse, gjatë hetimit shqyrton dhe vlerëson pretendimet e sinjalizuesit. Për këtë qëllim ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdherojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të marrë në pyetje persona në dijeni ose për rrethanat e cështjes ose të angazhojë dhe të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme, kur vlerësohet e nevojshme;
4. Në procesin e hetimit administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë edhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.
5. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, përfshirë:
 - a. Të drejtën për të paraqitur deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. Të drejtën për t'u njohur me dosjen e hetimit, me përjashtim të çdo informacioni, që mund të çojë në identifikimin e sinjalizuesit; të dhënat e sinjalizuesit paraqiten në mënyrë të anonimizuar;
 - c. Të drejtën për tu degjuar për pretendimet e parashikuara.
6. Institucioni është i detyruar të vërë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentat dhe provat që disponon.
7. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së masës. Gjithashtu, njësia përgjegjëse është e detyruar të përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve për çdo kërkesë me shkrim, të paraqitur nga sinjalizuesi në lidhje me ecurinë e cështjes.
8. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga njësia përgjegjëse rezulton se sinjalizimi ka elementë të një shkelje administrative, sipas ligjit njësia përgjegjëse, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

NENI 16

PROVAT NË HETIMIN ADMINISTRATIV

1. Njësia përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues, përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e njësive përgjegjëse kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë të dyshuara si të kundërligjshme. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër të ligjshme.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e njësive përgjegjëse vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, punonjësit bllokojnë dokumentacionin

apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente, gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga punonjësit e njësive përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhbllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e njësive përgjegjëse zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e njësive përgjegjëse dhe zyrtarët e insitucionit. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

NENI 17

PJESËMARRJA E SINJALIZUESIT GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Gjatë hetimit administrativ të sinjalizimit, sinjalizuesi mund të thirret për tu paraqitur nga njësia përgjegjëse apo të paraqitet me kërkesë të tij për të dhënë shpjegime apo akte provuese shtesë që janë të nevojshme për hetimin.
2. Kur sinjalizimi është anonim, paraqitja e shpjegimeve apo akteve provuese kryhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik që përmbushin garancitë për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit.

NENI 18

PJESËMARRJA E TË SINJALIZUARIT GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Personi i sinjalizuar apo personat e përfshirë, marrin pjesë në procesin e hetimit administrativ kur pjesëmarrja e tyre çmohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.
2. Në rastet kur njësia përgjegjëse vlerëson se thirrja e të sinjalizuarit apo personave të përfshirë mund të përbëjë rrezik për fshehjen, prishjen apo asgjësimin e provave, njoftimi mund të kryhet pas sigurimit të provave sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

NENI 19

PËRFUNDIMI I HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Njësia përgjegjëse përfundon hetimin administrativ kur:
 - a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi është i bazuar, ai referohet pranë autoritetit kompetent kur përmban elemente të kundërvajtjes administrative ose në organet e prokurorisë kur dyshohet për vepra penale. Referimi bëhet me të dhëna të anonimizuara ose të depersonalizuara në lidhje me identitetin e sinjalizuesit;

- b. sinjalizimi rezulton i pabazuar në fakte dhe të dhëna;
 - c. sinjalizuesi ka paraqitur me dashje informacion të rremë ose të pasaktë.
2. Në dosjen e sinjalizimit dokumentohet vendimi për përfundimin e hetimit administrativ, arsyet përkatëse që justifikojnë vendimmarrjen dhe çdo masë e marrë në lidhje me sinjalizimin.
 3. Ky vendim i përcillet sinjalizuesit në çdo rast, së bashku me arsyetimin përkatës, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të vecanre nga ana e tij.

KREU V

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

NENI 20

KONFIDENCIALITETI DHE DETYRIMI PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

1. Identiteti i sinjalizuesit dhe të dhënat e tjera të përfshira në sinjalizim ruhen në kushte konfidencialiteti nga njësia përgjegjëse dhe identiteti i sinjalizuesit mund të zbulohet vetëm me pëlqimin e tij të shprehur.
2. Identiteti i personit të përfshirë, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me të, ruhet dhe mbrohet në kushte konfidencialiteti nga njësia përgjegjëse.
3. Njësia përgjegjëse ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin e të dhënave e të informacionit të marrë nga sinjalizimi dhe të mos i përdorë apo t'i zbulojë ato për qëllime të tjera, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
4. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit dhe i të dhënave të përpunuara, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kryhet edhe pa pëlqimin e tij, vetëm në rastet kur është i domosdoshëm në mënyrë të arsyetuar e proporcionale për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor.
5. Në çdo rast njësia përgjegjëse i dërgon sinjalizuesit një njoftim me shkrim, që përmban arsyet e justifikuara për zbulimin e të dhënave konfidenciale, si dhe masat e marra për të kufizuar sa më shumë rrezikun e ekspozimit të panevojshëm.
6. Kryesisht, sinjalizuesi informohet para se të zbulohet identiteti i tij, përveç rasteve kur një informim i tillë do të rrezikonte hetimin ose procedimin gjyqësor.

NENI 21

MBROJTJA E SINJALIZUESIT

1. Sinjalizuesi që sinjalizon një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, gëzon mbrojtje ndaj çdo veprimi hakmarrës, të ndërmarrë nga institucioni sikurse përcaktohet në pikën 1 të nenit 8, ligjit nr.96/2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
2. Mbrojtja e sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrjeje sigurohet nëpërmjet mekanizmave të parashikuar në ligjin nr.96/2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

NENI 22

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

1. Përpunimi i të dhënave personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ kryhet vetëm për qëllime të zbatimit të ligjit nr.96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, e në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Të dhënat personale, që nuk konsiderohen të nevojshme për trajtimin e një sinjalizimi, nuk mblidhen. Nëse këto të dhëna mblidhen rastësisht, ato fshihen pa vonesë.
3. Në rast se gjatë zbatimit të këtij ligji konstatohet shkelje e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.
4. Të dhënat personale, që nuk i shërbejnë trajtimit të sinjalizimit, nuk përfshihen në hetimin administrativ.

NENI 23

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të Ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rast se të dhënat personale, që nuk konsiderohen të nevojshme për hetimin mblidhen rastësisht, ato fshihen menjëherë, dhe nuk përfshihen në hetimin administrativ.
3. Në rastet kur, gjatë zbatimit të Ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe kësaj rregulloreje konstatohen shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

NENI 24

RUAJTJA E TË DHËNAVE DHE ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Njësia përgjegjëse siguron gjurmueshmërinë e të dhënave e të informacionit, si dhe ruan dokumentacionin e krijuar në formë shkresore ose elektronike, në menyrë që të mundësohet rindërtimi i fazave të ndryshme të procesit të sinjalizimit, duke garantuar njëkohësisht konfidencialitetin e mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit dhe të personave të përfshirë.
2. Dokumentacioni origjinal ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur procedura ligjore përkatëse ende nuk ka përfunduar.

3. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore të regjistruara, sinjalizuesi informohet paraprakisht për regjistrimin. Sinjalizimi dokumentohet nëpërmjet një regjistrimi zanor në pajisje të përshtatshme për ruajtje dhe dëgjim ose nëpërmjet një transkripti të plotë. Në rast transkriptimi, sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen, duke nënshkruar dokumentin përkatës.
4. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonike të paregjistruar ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore të paregjistruara, biseda përshkruhet me shkrim në mënyrë të detajuar nga njësia përgjegjëse. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen, duke nënshkruar dokumentin përkatës.
5. Kur sinjalizimi bëhet verbalisht gjatë një takimi me njësinë përgjegjëse ose me autoritetin kompetent, sinjalizimi dokumentohet me pëlqimin e sinjalizuesit nëpërmjet regjistrimit zanor ose nëpërmjet hartimit të një procesverbali të takimit. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e dokumentuar, duke nënshkruar përkatësisht regjistrimin ose procesverbalin.

KREU VI DISPOZITA E FUNDIT

NENI 25 RAPORTIMI

Njësia përgjegjëse paraqet pranë ILDKPKI-së, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, sipas formatit të përcaktuar nga ILDKPKI-ja, bashkëlidhur kësaj rregulloreje “Formular raportimi i njësisë përgjegjëse në Bashki”.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM

DREJTUAR: Njesisë Përgjegjëse në Bashkinë Kamëz në zbatim të ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

1- Identiteti i sinjalizuesit:

☐ Sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____.

☐ Sinjalizues anonim, me kontakt _____.

*Shënim: Të dhënat e kontaktit nuk janë të detyrueshme për sinjalizuesin anonim. Ato kërkohen për të pasur mundësinë e vijimit të komunikimit me sinjalizuesin në funksion të hetimit.

2- Konteksti i punës së sinjalizuesit:

☐ I punësuar pranë autoritetit/subjektit të sinjalizuar.

☐ I punësuar më parë pranë autoritetit/subjektit të sinjalizuar.

☐ I vetëpunësuar

☐ Ofrues shërbimesh/furnizimi/nënkontraktor.

☐ Kontekst pune tjetër (specifiko): _____

3- Përshkrimi i fakteve e rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprime të kundërligjshme apo shkelje të kuadrit ligjor:

4- Parashikime të legjislacionit apo dispozita ligjore, për të cilat parashtrohet shkelja apo veprimi i kundërligjshëm (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë):

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e veprimeve të kundërligjshme apo shkeljeve të kuadrit ligjor të parashikuara në:

5- Aktet provuese në mbështetje të sinjalizimit:

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më ____/____/____, në _____ nga z./znj. _____, nëpunësi i Njesisë Përgjegjëse në Bashkinë Kamëz.

Sinjalizuesi
Emër Mbiemër

Nëpunësi Përgjegjës për Sinjalizimin
Emër Mbiemër

Regjistri i Sinjalizimit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz

[illegible]

FORMULAR RAPORTIMI I NJËSIVE PËRGJEGJËSE NË BASHKI

DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

I. IDENTIFIKIMI I NJËSISË PËRGJEGJËSE:

- Emërtimi i autoritetit publik/subjektit privat:
- Nëpunësi/t përgjegjës për sinjalizimin/pala e tretë e kontraktuar:
- Periudha e raportimit:
- Të dhënat e kontaktit:

II. TË DHËNA MBI NJËSINË PËRGJEGJËSE:

- Data e krijimit të Njesisë:
- Forma e organizimit:
 - ☐ Njësi brenda Autoritetit Publik/Subjektit Privat
 - ☐ Njësi e përbashkët midis disa subjekteve
 - ☐ Palë e tretë e kontraktuar
- Mjetet e sinjalizimit që mundësohen nga Njësia:
 - ☐ Sinjalizim verbal
 - ☐ Sinjalizim me shkrim
 - ☐ Mjete digjitale

III. STATISTIKA MBI SINJALIZIMET E REGJISTRUARA:

- Të dhëna mbi sinjalizimet.
 - a. Numri i përgjithshëm i sinjalizimeve të regjistruara: _____
 - b. Numri i sinjalizimeve të ndarë sipas formës së sinjalizimit:
_____ (sinjalizues i identifikuar) / _____ (anonim) / _____ (anonim por identifikuar gjatë hetimit).
- Numri i rasteve të ndara sipas kontekstit të punës së sinjalizuesit:
 - a. Sinjalizues është person i punësuar: _____
 - b. Sinjalizues ka qenë person i punësuar më parë: _____
 - c. Sinjalizuesi është subjekt kontraktor apo palë e tretë e lidhur në një kontekst pune: _____
 - ç. Tjetër kontekst pune (specifiko): _____
- Fusha e sinjalizimeve (numri i rasteve të ndara sipas fushës së sinjalizimit):

- ☐ Kundërvajtje administrative: _____
 - ☐ Vepër penale: _____
 - ☐ Prokurim publik: _____
 - ☐ Shërbime financiare / parandalimi i pastrimit të parave: _____
 - ☐ Mbrojtja e të dhënave personale/e drejta e informimit: _____
 - ☐ Deklarim pasurie / konflikt interesash: _____
 - ☐ Shëndeti publik: _____
 - ☐ Mbrojtja e mjedisit: _____
 - ☐ Tjetër (specifikoj fushat dhe numrin e rasteve): _____
-
-

IV. ADMINISTRIMI DHE HETIMI I SINJALIZIMEVE

- Numri i sinjalizimeve për të cilët është dërguar konfirmimi i regjistrimit brenda 7 ditëve: _____
- Numri i hetimeve të përfunduara brenda 90 ditëve: _____
- Kohëzgjatja mesatare e përfundimit të hetimit të rasteve të sinjalizuara: _____ ditë.
- Statusi i procedurave:
 - a. Numri i hetimeve të përfunduara gjatë vitit raportues: _____
 - b. Numri i hetimeve për të cilat vijon hetimi në përfundim të periudhës raportuese: _____

V. REZULTATET E PROCEDURËS HETIMORE

- Rastet e përfunduara apo mosfilluara:
 - a. Numri i sinjalizimeve të përfunduara si të bazuara: _____
 - b. Numri i sinjalizimeve të përfunduara si të pabazuara në fakte dhe të dhëna: _____
 - c. Numri i sinjalizimeve të përfunduara me të dhëna të rreme ose të pasakta: _____
 - ç. Numri i sinjalizimeve të mosfilluara (me të meta/jashtë fushës së zbatimit të ligjit/nuk ka elementë të kundërligjshëm nga shqyrtimi paraprak): _____ / _____ / _____
 - Masat e marra në vijim të përfundimit të hetimit:
 - ☐ Fillim procedure disiplinore për personat e gjetur në shkelje: _____
 - ☐ Masa administrative: _____
 - ☐ Referim në organet e prokurorisë: _____
 - ☐ Referim pranë organit kompetent: _____
 - ☐ Masa të tjera të ndërmarra për rregullimin e pasojave (specifikoj): _____
-
-

VI. ASISTENCA DHE MASAT PËR MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

- Numri i rasteve të këshillimit mbi sinjalizimin: _____

- Masa të ndërmarra për ruajtjen e konfidencialitetit, mbrojtjen e të dhënave dhe administrimin e dokumentacionit (specifiko):

- Numri i trajnimeve dhe personave të trajnuar mbi sinjalizimin:

- Problematika të identifikuara lidhur me procesin e sinjalizimit dhe hetimit të sinjalizimeve (specifiko):

Ky raport u hartua më ____/____/____, në _____ nga z./znj. _____, nëpunësi i Njesisë Përgjegjëse pranë Autoritetit Publik/Subjektit Privat _____.

NJËSIA PËRGJEGJËSE

Emër Mbiemër